REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE FINANCIARE DHE BUXHETIT
SEKTORI I PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT

Nr._____Prot. **Bilisht më, ____.____.2026**

PROJEKT-VENDIM
Nr. 72 datë 23.09.2026

PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT TË FAZËS SË DYTË TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2027-2029 – I RISHIKUAR

Bazuar në ligjin nr.139/2015 për "Vetqeverisjen Vendore" i ndryshuar, në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 për "Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, ligjit nr.68 datë 27.04.2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore", Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit", ligjit nr.87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026" i ndryshuar, udhëzimit nr.7 datë 27.02.2026 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2027-2029", pika 18 dhe Udhëzimit plotësues nr.17 datë 10.07.2026.

PROPOZOJ:

1 . Të miratojë Projektin e Dytë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 të Bashkisë Devoll sipas relacionit shpjegues për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm (shtojca 2), bashkëlidhur raportet e gjeneruara nga Sistemi i Menaxhimitt ë Buxhetit Vendor (SMBV) si më poshtë :

- PBA1 - Tavanet Përgatitore të PBA
- PBA2 - Parashikimi i të ardhurave 2027-2029
- PBA3 - Shpenzimet e NJVQV dhe Programit sipas Klasifikimit Ekonomik
- PBA4 - Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimit Funksional (Niveli I, II, III i COFOG).
- PBA5 - Shpenzimet sipas Programit dhe Klasifikimit Ekonomik.
- PBA6 - Deklarata e Politikës së Programit.
- PBA7 - Shpenzimet e Produkteve të Programit.
- PBA8 - Projektet e Investimeve.
- PBA9 – Informacion mbi NJVQV.

2.Për zbatimin e këtij Projekt Vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

Konceptoi: Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit të Buxhetit

Bledar DIKO

Konfirmoi :Dr. e Sherbimeve Financiare dhe Buxhetit

Aurela FURXHI

Miratoi bazën ligjore: Përgj. e Sektorit Juridik dhe Prokurimeve

Eriksela AVDO

EDUARD DURO

KRYETARI I BASHKISË